

**OBLIGIMET E KOMUNAVE NGA AGJENDA EVROPIANE  
PLANI GJITHPËRFSHIRËSE I KOMUNAVE JANAR-DHJETOR 2023**

<b>Data e dorëzimit të raportit:</b>	11.01.2024	
<b>Emri i komunës</b>	Komuna Klinë	
<b>Emri i Kryetarit të Komunës</b>	z. Zenun Elezaj	
<b>Emri i Zyrtarit Komunal për IE :</b>	Have Thaçi	
<b>Detajet kontaktuese:</b>	Have.thaqi@rks-gov.net;	
<b><u>Pjesa e ZKIE-ve</u></b>	Vetëm për Komunitat që mund të kenë pasur ndonjë ndryshim.	
<b>Zbatimi i rregullores Nr.08/2011 për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrave komunale për Integrim Evropian</b>	<p>1. Ju lutem specifikoni pozitën e ZKIE-së sipas akt emërimit ?</p> <p>2. A është themeluar Zyra Komunale për Integritime Evropiane në komunën tuaj konform rregullores nr.08/2011 për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrave komunale për Integritim Evropian ?</p> <p>3. A është emëruar Udhëheqësi i Zyrës për Integritime Evropiane në komunën tuaj konform Rregullores nr.08/2011 për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrave komunale për Integritim Evropian?</p> <p>4. Sa është numri i zyrtarëve në zyrën komunale për integritime evropiane?</p> <p>5. A janë të përfshira prioritetet dhe aktivitetet e fushës së Integritimit Evropian në planet vjetore të komunës ?</p> <p>6. A merr pjesë ZKIE në takimet për planifikim të buxhetit vjetor në mënyre që të përfshihen edhe obligimet e Agjendes Evropiane në planifikimin buxhetor?</p> <p>7. A merr pjesë ZKIE në takimet e rregullta të Kryetarit të Komunës me</p>	<p>1.Pozita sipas emërimit është : Zyrtare Komunale për Integritime Evropiane (ZKIE).</p> <p>2. Jo , Zyra Komunale për Integritime Evropiane nuk është themeluar konform Rregullores nr.08/2011 për organizimin dhe përgjegjësitë e Zyrave Komunale për Integritim Evropian.</p> <p>3 Jo nuk është emëruar Udhëheqësi i Zyrës për Integritime Evropiane.</p> <p>4. Një zyrtare.</p> <p>5. Po , prioritetet dhe aktivitetet e fushës së Integritimeve Evropiane janë të përfshira në planet vjetore të Komunës.</p> <p>6. Zyrtarja për Integritime Evropiane merr pjesë në takimet që mbahen për planifikim të buxhetit vjetor.</p> <p>7. ZKIE nuk merr pjesë në takimet e rregullta të Kryetarit të</p>

	Drejtorët Komunal?		Komunës me Drejtorët Komunal.	
<b>Objektivat</b>	<b>Drejtoria komunale përgjegjëse</b>	<b>Masat</b>	<b>Përmbledhja e aktiviteteve të kryera gjatë periudhës së raportimit Janar - Dhjetor 2023</b>	<b>Dispozitat e MSA-së</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li><b><u>BLLOKU I: KRITERET POLITIKE</u></b></li> </ul>				
<b>1. ADMINISTRATA PUBLIKE</b>				<b>Neni 120 i MSA-së: Administrata publike</b>
1.1. Forcimi i kapaciteteve të administratës në nivelin lokal, përfshirë komunat e sapo formuara, duke ofruar udhëzime nga niveli qendror tek ai lokal	<b>Të gjitha Drejtoritë/ Njësitë/ burimet njerëzore</b>	1. A është hartuar programi i trajnimeve për vitin 2023 në komunën tuaj? <i>Nëse po, ju lutemi të ofroni një dokument të tillë.</i>	1.Kemi Programin e Trajnimeve për vitin 2023 ( ju kemi ofruar dokumentin në raportimin paraprak).	

<p>1.2.Të ngritet transparenca e punës dhe vendimmarrjes të nivelit lokal</p>	<p>Zyra Kryetarit /Zyra informimit</p>	<p>1. A ka hartuar komuna juaj Startegjinë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, nëse po ju lutem të bashkangjiteni strategjinë e miratuar?</p> <p>2. A ka komuna juaj Planin vjetor të komunikimit, nëse po ju lutem të bashkangjiteni Planin ?</p> <p>3. A është duke u zbatuar Udhëzim Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komunën tuaj?</p> <p>4. A është caktuar zyrtari përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik në komunën tuaj? Ju lutem bashkangjiteni vendimin.</p> <p>5. Lidhur me rezultatet e procesit të konsultimit publik, a publikon komuna juaj raportin me të gjitha</p>	<p>1.Komuna e Klinës ka hartuar Strategjinë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun.</p> <p><a href="https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2023/03/STRATEGJIA-PER-KOMUNIKIM-DHE-MARRDHENIE-ME-PUBLIKUN-2023-2026.pdf">https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2023/03/STRATEGJIA-PER-KOMUNIKIM-DHE-MARRDHENIE-ME-PUBLIKUN-2023-2026.pdf</a></p> <p>2.Komuna ka Planin vjetor të komunikimit .</p> <p><a href="https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2023/03/PLANI-I-VEPRIMIT-PER-INFORMIM-DHE-KOMUNIKIM-2023-2026.pdf">https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2023/03/PLANI-I-VEPRIMIT-PER-INFORMIM-DHE-KOMUNIKIM-2023-2026.pdf</a></p> <p>3.Komuna e Klinës sa i përket organizimit të proceseve të konsultimeve publike ka arritur ti përmbushë kriteret e Udhëzimit Administrativ me afate kohore dhe me takime me qytetarë. Ju lutem të i referoheni vegzës së Konsultimeve Publike, në ueb faqen zyrtare Komuna Klinë si dhe platformën e Qeverisë për Konsultime Publike: <a href="https://kk.rks-gov.net/kline/category/konsultimet-publike/">https://kk.rks-gov.net/kline/category/konsultimet-publike/</a> ;</p> <p>4. Në çdo komunë, përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik është Njësia/zyrtari për komunikim publik. Vendimi i bashkangjitur në periudhën raportuese paraprake).</p>	

		propozimet e ofruara nga qytetarët, si dhe a ofron sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve të tjera të interesuara. (ju lutem e bashkangjitni linkun e publikimit të raporteve)?	5. Raporti i Shqyrtimit Publik, publikohet më së paku pesëmbëdhjetë ditë dhe më së voni tridhjetë(30) ditë nga data e fundit e takimit me qytetarë.	
1.3.Të vazhdohet procesi i decentralizimit për komunat: <b>Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zvecan, Leposaviq</b>	<b>Drejtoria e Administratës</b>	<p>1. A janë emëruar Drejtorët e Drejtorive në komunën tuaj ?</p> <p>2. Sa është numri i Drejtorive në komunën tuaj ?</p> <p>3. A është themeluar Qendra për shërbim të qytetarëve?</p> <p>4. A është duke funksionuar sistemi i intranetit në kuadër të shërbimeve administrative që ofron komuna juaj ?</p> <p>5. A është arritë të bëhet migrimi i të dhënave nga uebfaqja e vjetër në atë të re?</p>	<p>1.Po janë të emëruar Drejtorët e Drejtorive në Komunën tonë.</p> <p>2. Janë dhjetë Drejtori.</p> <p>3. Po , Qendra për shërbim të qytetarëve është e themeluar.</p> <p>4. Po sistemi i intranetit është funksional dhe përmes këtij sistemi trajtohen te gjitha kërkesat e qytetarëve.</p> <p>5. Po, kur është ndërtuar versioni i ri i ueb faqes janë migruar shënimet ndërsa u bënë shumë vite që kurë ueb faqja aktuale është në shërbim . Çfarëdo informacioni për publikun vendoset në këtë ueb faqe : <a href="https://kk.rks-gov.net/kline/">https://kk.rks-gov.net/kline/</a>.</p>	
<b>3.SHOQËRIA CIVILE</b>				

<p>3.1.Të rritet bashkëpunimi në mes të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të Qeverisë së Kosovës, si dhe të sigurohet financim publik për shoqërinë civile</p>	<p><b>Drejtoria për Financa dhe Buxhet</b></p>	<p>1. Sa ka ndarë buxhet komuna juaj për mbështetjen e projekteve të OSHC-ve konform Rregullores 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publikë të OJQ-ve?</p> <p>2. Sa është numri i OSHC-ve të përkrahura financiarisht nga komuna juaj ?</p> <p>3. A ka përkrahur komuna juaj, projekte të OJQ-ve për përkrahjen e komuniteteve.</p> <p>4. Nëse po, specifikoni numrin e projekteve të përkrahura dhe ju lutem ofroni shumën totale të këtyre projekteve?</p>	<p>1. Komuna e Klinës – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka ndarë <b>65.000€</b> për OSHC-të .Përzgjedhja bëhet përmes thirrjes publike konform Rregullores.</p> <p>2. Janë <b>26</b> OSHC të përkrahura financiarisht .</p> <p>3. Nga komunitetet nuk ka aplikuar asnjë OJQ, por DKRS ka përkrahur OJQ me aktivitete sportive, rinore e kulturore që përfshijnë edhe komunitetet si pjesëmarrës.</p> <p>4. Janë 6 projekte, me shumë totale 10.000€ .</p>	
<p><b>4.LUFTA KUNDËR TERRORIZMIT</b></p>				<p>Neni 92: Lufta kundër terrorizmit - MSA</p>

<p>4.1.Të përforcohen strukturat e Kosovës në parandalimin dhe eliminimin e akteve terroriste dhe financimit të tyre</p>	<p><b>Drejtoria a Arsimit/Zyra e Kryetarit</b></p>	<p>1. Në bashkëpunim me Ministrit e Linjës dhe institucionet/organizatat tjera a është organizuar ndonjë trajnim i detyrues për zyrtarët komunal të arsimit, mësuesit, menaxhmentin e shkollave për të identifikuar të rinjtë që janë në rrezik për ekstremizëm dhe se si të veprojnë në raste të tilla ?</p> <p>2. Cilat janë veprimet/aktivitetet që ka ndërmarrë komuna e juaj për vetëdijësimin e qytetarëve kundër radikalizmit që mund të shpiej në ekstremizëm të dhunshëm ?</p> <p>3. A ka pasur ndonjë rast të raportuar në KKSB për aktivitetet që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin?</p>	<p>1. Jo , nuk ka pasur trajnime të kësaj natyre.</p> <p>2. Në këtë periudhë nuk ka pasur.</p> <p>3. Jo , gjatë mbledhjeve që kemi mbajtur nuk kemi pasur ndonjë rast të raportuar të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.</p>	
<p>4.2.Të krijohen mekanizma për raportim obligativ lidhur me konfliktin e interesit si dhe të</p>	<p><b>Kordinatori i Sekretariatit/ Kuvendi i Komunës</b></p>	<p>1. Sa është numri i rasteve të paraqitura të konflikteve të</p>	<p>1. Jo nuk ka pasur.</p>	

<p>ashpërsohen sanksionet lidhur me mos deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesit , si dhe për zbatimin e politikave të tjera kundër korrupsionit</p>		<p>interesit nga zyrtarët komunal?</p> <p>2. Sa është numri i anëtarëve të kuvendit që kanë deklaruar konfliktin e interesit para marrjes së vendimeve në kuvend të komunës?</p>	<p>2. Jo nuk ka pasur.</p>	
<p>4.3.Monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit;</p>	<p><b>Kordinatori i Sekretariatit/ Kuvendi i Komunës</b></p>	<p>1. A ka hartuar komuna juaj Planin Lokal për Integritet, konform ligjit Nr. 03/1- 159 për agjencinë kundër korrupsionit nëse po ju lutem të bashkangjiteni planin e miratuar?</p> <p>2. A ka komuna juaj koordinator që monitoron dhe raporton lidhur me planin për integritet, nëse po ju lutem të bashkangjiteni vendimin.</p>	<p>1.Komuna e Klinës ka hartuar Planin Lokal për Integritet, konform ligjit Nr. 03/1- 159 për agjencinë kundër korrupsionit, linku:</p> <p><a href="https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/01/20240105131536.pdf">https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2024/01/20240105131536.pdf</a></p> <p>Vendimi i miratimit, i datës; 29.12.2023: <a href="https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2023/12/Scan_2018_02_01_11_48_45_940.pdf">https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2023/12/Scan_2018_02_01_11_48_45_940.pdf</a></p> <p>2.Komuna e Klinës ka caktuar Zyrtaren përgjegjëse për menaxhimin e përgatitjes dhe zbatimin të Planit të Integritetit në kuadër të institucionit ,të bashkangjiteni vendimin:</p> <p><a href="https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2023/10/P.-">https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2023/10/P.-</a></p>	

Integritetit.pdf

4.4.Të përmirësohet implementimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve

Zyra  
ligjore/Zyra  
informimit

1 Çfarë veprime ka ndërmarrë Komuna për të krijuar qasje për shërbime në gjuhët zyrtare në nivel komunal, duke përfshirë gjuhët në përdorim në zyrtarë?

2.A publikohen të gjitha aktet komunale në gjuhët zyrtare ashtu sic parashihen me ligjin për përdorimin e gjuhëve si dhe rregullores komunale për gjuhët zyrtare?

1.Komuna e ka përkthyesin zyrtar Shqip-Serbisht-Shqip.

Dokumentet zyrtare janë në dispozicion në të dy gjuhët zyrtare që përdoren në Komunën e Klinës.

2. Aktet komunale ( vendimet, rregulloret, procesverbalet, konkurset, shpalljet, njoftimet etj.) përgatiten në të dy gjuhët zyrtare dhe publikohen përmes ueb faqes (në të dy versionet e gjuhëve zyrtare) , po ashtu edhe në tabelën njoftuese të shpalljeve të Komunës.

**5. MBROJTJA DHE PROMOVIMI TRASHËGIMISË KULTURORE**



<p>5.1. Avancimi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore</p>	<p>Drejtoria e Kulturës/ Drejtoria përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë (Urbanizmi)</p>	<p>2. A është themeluar Muzeu i Natyrës në Komunën tuaj? <b>(Fushë Kosova)</b></p>		
--	---	--	--	--

5.2. Të implementohet legjislacioni që ka të bëjë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore

**Drejtoria e Kulturës/  
Drejtoria përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë (Urbanizmi)**

1. A ka hartuar komuna juaj Planin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore konform Strategjisë Kombëtare për Trashëgimi Kulturore ?
2. Nëse jo cilat janë sfidat/arsyjet që komuna juaj ende nuk e ka hartuar Planin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore ?
3. Sa është numri i shkeljeve dhe ndërtimeve ilegale në zonat e mbrojtura?
4. Çfarë masa janë ndërmarrë ndaj shkeljeve të evidentuara të ndërtimeve pa leje në zonat e mbrojtura?
3. A janë siguruar pajisjet për monitorimin e sigurisë/instalimi i kamerave të tërësive të objekteve të trashëgimisë kulturore (objektet e kultit fetar, zonat e mbrojtura, muzetë, etj) ?
6. A janë nënshkruar Memorandume të bashkëpunimit për detyrat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e Kishave Ortodokse? (Vetem komunat që kanë kisha) ?

1. Jo nuk është hartuar ende, po punohet për t'u hartuar.
2. Jemi në përpjekje të formimit të një Komisioni Punues i cili së pari duhet të evidentoj të dhënat për objektet e trashëgimisë kulturore dhe të njëjtat të përditësohen edhe në listën e objekteve kulturore në mbrojtje nga MKRS.
3. Nuk ka shkelje dhe ndërtime pa leje.
4. Drejtoria Komunale e Inspektoratit, inspekton vazhdimisht zonat e mbrojtura , parandalon dhe gjyben tentimet për punime - konform ligjeve.
5. Pajisjet për monitorimin e sigurisë janë të vendosura në objektet e kultit , lokalitetin arkeologjik në Dersnik dhe në kishën ortodokse në Budisalc .
6. Memorandumi i bashkëpunimit për mirëmbajtjen e Kishës së Budisalcit është nënshkruar para disa viteve. Është formuar Komisioni dhe objekti është nën vëzhgimin e Policisë.

<p>5.3.Zbatimi i Ligjit për Hoçën e Madhe. Krijimi i Këshillit të fshatit dhe zgjedhja e anëtarëve për zbatimin e Ligjit për Hoçën e Madhe? Arsyet nëse nuk është bërë ende dhe cilat janë planet tuaja dhe të komunës</p>	<p><b>Sekretaria e Kuvendit Komunal/Zyra për Fshatin Hoqë e Madhe</b></p>	<p>1. Cilat janë veprimet që komuna e Rahovecit ka ndërmarrë për funksionimin e Këshillit për Hocën e Madhe?</p> <p>2. A është alokuar buxheti për Këshillin e fshatit të Hoqës së Madhe për të mundësuar funksionimin e suksesshëm dhe sa është shuma?</p>		
<p>5.5.Ndërmarrja e veprimeve në adresimin e problemit të ndërtimeve ilegale brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura (ZVM)? Raportim mbi aktivitetet e ndërmarrja nga Task Forca e ngritur për t'u marrë posaçërisht me ndërtimet e paligjshme në Prizren. Planet e ardhshme për këtë Task Force sipas qeverisë së re</p>	<p><b>Sekretaria e Kuvendit Komunal</b></p>	<p>1. Cilat janë veprimet e komunës për zbatimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit?</p>		

		<p>2.A është alokuar buxheti për këshillin e Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit për të mundësuar funksionimin e suksesshëm dhe sa është shuma?</p> <p>3.Sa është numri i ndërtimeve ilegale brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura në Komunën e Prizrenit?</p> <p>4.Çfarë aktivitete ka ndërmarrë Task Forca për sa i përket ndërtimeve të paligjshme, në Komunën e Prizrenit?</p> <p>5. A janë caktuar inspektorët komunal për të inspektuar ndërtimet pa leje në Zonën e Mbrojtur të qytetit?</p> <p>6. Cfarë aktivitete ka ndërmarrë komuna e Prizrenit me qëllim të rehabilitimit të shtratit të lumit Lumbardhi?</p>		
<p>5.6. Raportoni lidhur me organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe promovimin e përkushtimit më të fuqishëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore</p>	<p><b>Drejtoria e Kulturës</b></p>	<p>1.Listoni aktivitetet që komunat ka ndërmarrë për ndërgjegjësimin dhe promovimin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore ?</p>	<p>1. Aktivitetet që Komuna ka ndërmarrë janë:</p> <p>-Vizita në shkolla dhe sesionet informuese, kryesisht me nxënës.</p>	

-Organizimi i aktiviteteve kulturore e rinore në objektet dhe zonat e shënuara si pasuri të trashëgimisë kulturore.

-Fletëpalosje dhe shpërndarja e tyre në shkolla, institucione tjera dhe në shoqëri.

-Mbështetje e projekteve promovuese për OJQ-të me aktivitete kulturore.

-Memorandum bashkëpunimi me CDF për krijimin e shtigjeve dhe shënjimin , që lehtësojnë rrugën dhe promovimin e objekteve dhe zonave arkeologjike, kulturore e natyrore.

## 2. BLOKU II: KRITERET EKONOMIKE

### 1. EKZISTENCA E EKONOMISË FUNKSIONALE TË TREGUT

1.1. Përmirësimi i mëtejshëm i ambientit në të bërit biznes si dhe procedurat e planifikimit të buxhetit

**Drejtoria për  
Zhvillim  
Ekonomik**

1.A është themeluar Qendra për regjistrimin e bizneseve (*one-stop shopet*) në komunën tuaj?

2. Sa është numri i inspektorëve të tregut në komunën tuaj?

1.Po është themeluar Qendra për regjistrimin e bizneseve .

2. Dy (2) inspektor të tregut .

		<p>3. Sa është numri i inspektimeve gjatë periudhës raportuese?</p> <p>4. Sa dëgjime publike janë mbajtur për planifikimin e buxhetit?</p>	<p>3. Duke ushtruar kompetencat ligjore në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë për personat fizik dhe ata juridik janë proceduar <b>276</b> kërkesa të ndryshme .</p> <p>Prej tyre <b>266</b> janë shqyrtuar dhe zgjidhur sipas procedurës së paraparë ligjore; <b>8</b> janë refuzuar si të pa bazuara ; <b>2</b> janë anuluar, <b>2</b> janë në procedurë të pritjes .</p> <p>4. Janë mbajtur 17 dëgjime publike për planifikimin e buxhetit.</p>	
<b>2. TATIMET</b>				<b>Neni 105 Tatimet - MSA</b>
2.1. Zvogëlimi i nivelit të ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal;	<b>Drejtoria e Inspektoriatit</b>	1. Cilat janë masat që ka ndërmarrë komuna juaj ndaj subjekteve ekonomike me qëllim të parandalimit të ekonomisë joformale ?	1. Masat që ka ndërmarrë Komuna ndaj subjekteve ekonomike me qëllim të parandalimit të ekonomisë joformale janë Inspektimet dhe këshillimet e rregullta e të shpeshta që kryhen në teren nga zyrtarët Komunal .	
2.2. Zbatimi i Reformës së Menaxhimit të Financave Publike		<p>1. Sa rekomandime ka dhënë Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) në raportin më të fundit për Komunën tuaj.</p> <p>2. Sa rekomandime të ZKA-</p>	1. Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë <b>12</b> rekomandime.	

		<p>së i keni adresuar?</p> <p>3. Sa rekomandime të ZKA-së kanë mbetur pa u adresuar?</p> <p>4. Sa rekomandime të ZKA-së gjenden në proces?</p> <p>5. A funksionon Njësia e Auditimit të Brendshëm në komunën tuaj, nëse po sa zyrtarë janë të angazhuar në këtë njësi?</p> <p>6. A ka themeluar komuna juaj komitetin për auditim të brendshëm?</p>	<p>2 . Janë adresuar të gjitha.</p> <p>3. Nuk ka rekomandim të pa adresuar .</p> <p>4. //</p> <p>5.Njësia e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Klinës është funksionale dhe përbëhet nga 2 zyrtarë: Udhëheqësi i NjAB dhe Auditori i Brendshëm.</p> <p>6. Komuna e Klinës ka të themeluar Komitetin e Auditimit të Brendshëm në përbërje prej 5 anëtarësh.</p>	
2.3. Planfikimi i pronës komunale për zhvillim ekonomik lokal		1. A është publikuar regjistri i pronës komunale, bashkangjitni linkun i regjistrit të pronave në kuadër të ueb faqeve zyrtare të komunave ?	<p>1.Po është publikuar.</p> <p><a href="https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2022/12/Lista-e-pergjithshme-e-pronave-te-palujtshme-komunale.pdf">https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2022/12/Lista-e-pergjithshme-e-pronave-te-palujtshme-komunale.pdf</a></p>	
<b>3. NDËRMARRJET DHE POLITIKAT E INDUSTRIË</b>				
13				
3.1.Ndërtimi i një infrastrukture fizike, të kompletuar dhe të		1. A është bërë funksionalizimi i zonave ekonomike në komunën	1. Pjesërisht , është duke u punuar.	

gatshme për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve		tuaj?		
<b>3. BLOKU III: STANDARDET EVROPIANE</b>				
<b>1. BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL</b>				<b>Neni 26 i MSA-së: Bujqësia dhe Peshkataria</b>
1.1. Rregullimi i mëtejshëm i tokës bujqësore dhe mbrojtjes nga ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore	<b>Drejtoria për Bujqësi</b>	<p>1. A ka hartuar komuna juaj Plan Program për Bujqësi dhe Zhvillim Rural nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar?</p> <p>2. Sa është numri i kërkesave të parashtruara për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore?</p> <p>3. Sa është numri i vendimeve të miratuara për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore?</p>	<p>1. Është në procedurë.</p> <p>2. Nuk ka.</p> <p>3. Nuk ka.</p>	
1.2. Konsolidimi i mëtejshëm i qendrave informative këshilluese komunale për bujqësi dhe zhvillim rural	<b>Drejtoria për Bujqësi</b>	<p>1. A janë funksionalizuar qendrat informative për këshillimin e fermerëve në komunën tuaj?</p> <p>2. A ka mbështetur komuna juaj fermerët në sektorin e drithrave, hortikulturës, blegtorisë etj nëse po ju lutem cekni sektorin dhe</p>	<p>1. Po , janë funksionale Qendrat informuese .</p> <p>2. Komuna i ka mbështetur fermerët me 210 sera ( 4x8), 20 freza. Pritet të shpëndahen edhe 10 makina mbjellëse të grurit dhe 10 makina mbjellëse të misrit. Komisioni ka</p>	



		<p>numrin e fermerëve të përkrahur?</p>	<p>bërë përzgjedhjen e përfituesve por ende nuk është bërë shpërndarja e tyre. Gjithashtu janë shpërndarë edhe 15 shkrirëse të dyllit - për bletarë.</p> <p>Ndërsa janë bërë 1098 aplikime për subvencione në MBZHR.</p>	
<p>1.3. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e tokës bujqësore</p>	<p><b>Drejtoria për Bujqësi</b></p>	<p>1. A ka komuna juaj inspektor të bujqësisë?</p> <p>2. Në rast se komuna juaj nuk ka inspektorë të bujqësisë, kush e realizon këtë funksion ?</p> <p>3. Sa është numri i inspektimeve?</p> <p>4.A keni raste në komunën tuaj të humbjes së tokës Bujqësore? .</p> <p>5.Nëse po, çfarë veprime ka ndërmarr komuna juaj për parandalimin e humbjes së tokës bujqësore?</p>	<p>1. Po , <b>një</b> Inspektor të Bujqësisë dhe Ambientit .</p> <p>2.Inspektimet kryhen nga Inspektori i Bujqësisë dhe Ambientit.</p> <p>3.Gjatë periudhës raportuese për vitin <b>2023</b> nga Inspektori i bujqësisë dhe ambientit janë ushtruar këto aktivitete : <b>62</b> kontrolle inspektuese prej tyre janë bërë <b>62</b> procesverbale mbi konstatimin e gjendjen faktike ne teren.</p> <p>4.Jo ,nuk kemi pasur raste të humbjes se tokës bujqësore</p>	

			5./	
1.4. Planet për menaxhimin e tokave rurale (zonimi)	Drejtoria e Bujqësisë	1. A posedon komuna e juaj Planin për Menaxhimin e tokave rurale, nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar ?	1. Jo , nuk e ka Komuna Planin për Menaxhimin e tokave rurale. -Një Plan i punuar nga ALLUP para shumë vjetësh si pilot -projekt.	
<b>ENERGIJA</b>				<b>Neni 114 Energjia- MSA</b>
2.1. Reformimi i strukturave institucionale në fushën e energjisë dhe ngritja e kapaciteteve të tyre, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe acquis-së së transpozuar	Drejtoria e Shërbimeve Publike	1. A ka miratuar komuna juaj Planin për Efiqencë të Energjisë, konform Ligjit për Energji Elektrike nëse po, ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar ?  2. Cilat janë projektet konkrete për zbatimin e planit për eficientë të energjisë, specifikoni së paku tri projekte?	1. Komuna jonë ende nuk ka miratuar Planin për efiçencë të energjisë.  2. Komuna jonë ka projekt me FKEE (Fondin i Kosovës për Efiçencë të energjisë). Zbatimi i masave të efiçencës së energjisë në objektet shkollore: - SHFMU “ 3 Dëshmorët”; -SHFMU “Avni Zhabota”; -SHFMU “Dëshmorët e Qëndresës”; -SHFMU “ Motrat Qiriazhi” .  Momentalisht janë në procedurë tenderime tek Fondi i Kosovës për Energji Efiçiente. Projekti për shtim të masave efiçiente për ndërtesat sociale në pronësi të Komunës së Klinës si : izolimi, ndërrimi i dritarve, dyerve dhe gjërave tjera përcjellëse.	
<b>4. GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE</b>				

<p>4.1.Zbatimi i pakove ligjore për të drejtat e njeriut</p>	<p>Njësia për të Drejtat e Njeriut</p>	<p>1. A është emëruar zyrtari përkatës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut?</p> <p>2. A është emëruar zyrtari përkatës për mbrojtjen e diskriminimit ?</p> <p>3.A është emëruar zyrtari përkatës për Barazi Gjinore?</p> <p>4. Sa ka ndarë buxhet komuna juaj për zhvillimin e aktiviteteve në fushën e të drejtave të njeriut ?</p>	<p>1.Po , është emëruar me një Vendim nga Kryetari si punë shtesë.</p> <p>2.Po, është emëruar me një vendim nga Kryetari si punë shtesë.</p> <p>3.Po është emëruar.</p> <p>4. Janë të ndara 5000€ për aktivitetet e kësaj fushe.</p>	
<p>4.2 Zbatimi i pakove ligjore për kujdesin për të moshuarit</p>		<p>1.A ofron Komuna juaj përkujdesje rezidenciale për të moshuarit, konform legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë?</p> <p>2.Nëse po, sa qendra të përkujdesjes për të moshuarit gjenden në Komunën tuaj?</p>	<p>1.Jo, Komuna e Klinës nuk ka Institucion rezidencial për të moshuar. Rastet e tilla strehohen në Shtëpinë për të moshuar në Gurakoc-Istog.</p> <p>Punimet kanë filluar për ndërtimin e objektit.</p> <p>2.//</p>	

4.2.Të drejtat e grave dhe barazia gjinore

**Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete**

- 1. A ka hartuar komuna juaj Strategjinë kundër dhunës në familje, konform strategjisë kombëtare nëse po ju lutem të bashkangjiteni dokumentet e miratuar ?
- 2. A ka hartuar komuna juaj Planin e Veprimit kundër dhunës në familje, konform strategjisë kombëtare nëse po ju lutem të bashkangjiteni dokumentet e miratuar ?
- 3. Sa raste të dhunës mbi baza gjinore ka trajtuar komuna juaj ?
- 4.Cfarë masa ka ndërrmar komuna juaj për viktimat e dhunës në familje konform ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje ?
- 5.A ka themeluar komuna këshillin komunal (komitet) për mbrojtën e viktimave te dhunës në familje, nëse po sa takime janë mbajtur?

- 1 Komuna e Klinës është në proces të hartimit të Sratategjis kundër dhunës në familje konform strategjisë Komtare. Ka filluar me nënshkrimin e Marrveshtjës në fund te vitit 2023 ku është nenshkruar Marrveshtje Mirëkuptimi për Institucionalizimin e Mekanizmit Koordinues për Mbrojtje nga dhuna në Familje. ( Marrveshja do të bashkangjitet ne attach.)
- 2.Komuna jonë është në proqes të hartimit të Planit të Veprimit kundër dhunës në Familje për periudhën 2024 – 2026.
- 3.Komuna e Klinës, përkatësisht Qendra për Punë Sociale, gjatë periudhës raportuese ka trajtuar gjithsejtë 17 raste .
- 4.Zyrtarët e shërbimeve sociale të angazhuar në Qendrën për Punë Sociale, i kanë marr të gjitha masat për t’iu ofruar ndihmë viktimave të dhunës ne familje ashtu siç edhe parashihet me Ligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje, krejt kjo në bashkëpunim edhe me policinë, shtëpinë e sigurt, mbrojtësen e viktimave, gjykatën kompetente si dhe me OJQ- të e ndryshme të licencuara për ofrim të shërbimeve sociale për viktimat e dhunës në familje.
- 5. Po ,  
Marrveshja e bashkangjitur.

<p>4.3.Të fuqizohet roli dhe pozita e grave në shoqëri</p>	<p>Njësia për të Drejtat e Njeriut</p>	<p>1. Sa është numri i grave në pozita menaxheriale në të gjitha institucionet e komunës duke përfshirë dhe komunitetin jo shumicë (p.sh. administratë, shkolla, QMF etj) ?</p> <p>2.Sa është numri total i përfaqësimit të grave në administratën publike lokale duke përfshirë Kuvendin e Komunës, duke përfshirë dhe komunitetin jo shumicë ?</p> <p>3. Sa është numri i grave që janë Drejtore të Drejtorive në Komunën tuaj?</p>	<p>1.Numri i grave në pozita menaxheriale është si në vijim</p> <p>-Administratë 4 -Arsim 4 -Shëndetësi 4</p> <p>2.Numri i të punësuarave në Administratën e Komunës të gjinisë femërore është 33, kemi edhe 12 Këshilltare Komunale. Gjithsej janë 45 femra.</p> <p>3. Kemi një drejtoreshë në ekzekutivin e Komunës</p>	
<p>4.4.Zbatimi i të drejtave pronësore</p>	<p>Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete/Zyra për Barazi Gjinore</p>	<p>1. Cilat janë veprimet që ka ndërmarr komuna juaj me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe përmirësimit për të drejtat pronësore të grave, dhe cila është natyra e tyre?</p> <p>2. Sa prona janë të regjistruara në emër të dy bashkëshortëve?</p>	<p>1.Me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit për të drejtat pronësore të grave ofron lehtësime në regjistrimin e drejtës në pronën . Liron nga pagesa regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve përmes Udhëzimit të regjistrimit të drejtës në paluajtëshmëri .</p> <p>2.Në emër të dy bashkëshorteve në këtë periudhë janë regjistruar gjithsej 223 prona.</p>	

<p>4.5. Zbatimi i Ligji për Mbrojtjen e fëmijës</p>		<p>1. Cilat janë sfidat me të cilat ballafaqësohet komuna juaj në zbatimin e ligjit për mbrojtjen e fëmijës?</p> <p>2.A ka ndonjë mekanizëm të veçantë komuna e juaj me të cilin promovohet dhe mbrohen të drejtat e fëmijëve ?</p> <p>3. A është organizuar ndonjë fushatë vetëdijësuses-edukese në komunën tuaj mbi promovimin dhe njohjen e të drejtave te fëmijëve në komunën tuaj,</p> <p>4. A është caktuar njësia apo zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës ?</p> <p>5. A janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara, hapësirat e punës në institucionet lokale?</p> <p>6.A janë të qasshme objektet arsimore për personat me aftësi të kufizuar?</p>	<p>1.Trajnimi i stafit, rritja e aktiviteteve ndërgjegjësuese etj.</p> <p>1. Po, funksionon Ekipi komunal dhe Zyrtari komunal për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.</p> <p>1. Deri më tash nuk është organizuar ndonjë fushatë e kësaj natyre.</p> <p>2. Po , është caktuar Zyrtari komunal në Drejtorinë e Arsimit.</p> <p>5.Po.</p> <p>6.Po.</p>	
---	--	--	---	--

		<p>7.A kane asistencën e duhur në procesin mësimor personat me aftësi të kufizuar, sipas legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë?</p> <p>8. A ofron Komuna Juaj kujdestari për fëmijës pa përkujdesje prindërore sipas formave themelore të mbrojtjes juridike dhe familjare, bazuar në legjislacionin në fuqi.</p>	<p>7. Po. Të gjithë fëmijët me nevoja të veçanta që janë përfshirë në sistemin arsimor trajtohen sipas Ligjeve të zbatueshme. Ekzistojnë asistentët dhe mësuesit mbështetës të profesionalizuar për kategorinë e nxënësve me nevoja të veçanta.</p> <p>8. Sigurisht që po, Qendra për Punë Sociale ofron kujdestari për fëmijët pa përkujdesje prindërore, strehim rezidencial për këta fëmije, strehime familjare etj. Krejt kjo bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës.</p>	
<p>4.6.Lufta kundër trafikimit me qenie njerëzore</p>	<p>Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete /Drejtoria për Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale</p>	<p>1. A është e hapur dhe funksionale strehimorja për viktimat e trafikimit në komunë tuaj? <b>(Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj, Gjakovë)</b></p> <p>2.A e ka të miratuar Komuna Juaj Planin tre-vjeçar për strehim Social konform Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit ? Nëse po ju lutem ta bashkëngjitni Planin?</p>	<p>1.Jo, në Komunën tonë nuk kemi strehimore për viktimat e trafikimit.</p> <p>2.Po, është miratuar Plani 3 vjeçar i banimit. (e kemi të bashkangjitur në periudhën paraprake raportuese).</p>	

<p>4.7. Incimi i funksionalizimit të Komunitetit Konsultativ për Personat em Aftësi të Kufizuar</p>		<p>1. A është themeluar Komiteti konsultativ për Personat me aftësi të kufizuara në komunën tuaj?</p>	<p>1. Po është Formuar Këshilli Komunal për Persona me aftësi të kufizuara.</p>	
<p>4.8. Ofrimi i ndihmës juridike falas për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, pa dallim etnie</p> <p><b>7 (shtatë) regjione të Republikës së Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjakovë dhe Gjilan.</b></p>	<p>Drejtoria e Administratës</p>	<p>1.A është funksionalizuar Zyra Rajonale për ndihmë juridike falas ? <b>(Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj, Gjakovë).</b></p> <p>2. A janë themeluar në komunë tuaj Zyrat mobile për ndihmë juridike falas si formë e organizimit të shërbimeve juridike konform Ligji nr. 04/l-017 për ndihmë juridike falas</p> <p>3. Sa është numri i kërkesave për ndihmë juridike falas në komunën tuaj?</p>	<p>1.Po.</p> <p>2. Po është themeluar Zyra mobile për ndihmë juridike falas si formë e organizimit të shërbimeve juridike konform Ligji nr. 04/l-017 për ndihmë juridike falas .</p> <p>3.ANJF-Zyra për Ndihmë Juridike Falas në Komunën e Klinës, gjatë vitit 2023 kemi trajtatur dhe kemi ofruar shërbime juridike falas <b>gjithësej 146</b> rasteve apo qytetarëve . Shërbimet juridike falas të ofruara ndahen në këtë mënyrë:</p> <p>1. Lëminë Administrative 105 raste : Kërkesa, ankesa dhe Padi;</p> <p>2. Lëminë Civile 37 raste: Prapësime, Propozime, Padi dhe Angazhim të Avokatëve të OAK-së;</p> <p>3. Lëminë Kundërvajtje 1 rast : Ankesë ;</p> <p>4. Lëminë Penale 3 raste : Këshilla Juridike dhe Ankesë;</p>	
<p><b>5 .MBROJTJA E MINORITETEVE</b></p>				



<p>5.1. Buxheti dhe sfidat në nivel qendror dhe lokal</p>		<p>1. Sa është numri i të punësuarave në të gjitha institucionet e komunës, nga komunitet jo shumicë në pajtim me përqindjen e popullatës në komunë ?</p>	<p>1. Numri i të punësuarve të komuniteteve jo shumicë është si në vijim:          -Administratë 4;          -Arsim 3;          -Shëndetësi 1;</p>	
<p>5.2. Zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Komunitetet Rom dhe Ashkali, përmirësimi i shkallës së regjistrimit civil për komunitetet rom, dhe ashkali</p>	<p><b>Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim</b></p>	<p>1. A është realizuar fushata për regjistrimin falas të Komuniteteve Rom dhe Ashkali?</p> <p>2. A është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në komunën tuaj, nëse po ju lutemi na bashkangjiteni këtë Plan? (për komunat që i kanë këto komunitetet)</p> <p>3. A është themeluar komiteti lokal veprues për zbatimin e Strategjisë për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian</p>	<p>1. Jo nuk ka pasur .</p> <p>2. Jo ende.</p> <p>3. Jo ende .</p>	

**6. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA**

**Neni 83 Liria, Siguria dhe Drejtësia- MSA**

6.1.Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës së politikave në fushën e migracionit, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe të legjislacionit të përafëruar

**Zyra Komunal për Kthim dhe Komunitete**

1.A është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Riintegrim në komunën tuaj, nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar?  
  
2.A ka themeluar komuna juaj Komisionin Komunal për Riintegrim (KKR)?

1. Plani për riintegrim është miratuar.  
  
Dokumenti do të jet i bashkangjitur.  
  
2. Po ka Komision për riintegrim.

**7.MENAXHIMI I KUFIJVE DHE MIGRIMIT**

**Neni 85- Vizat,menaxhimi i kufijve, azili dhe migracioni- MSA**

7.1. Ofrimi i mundësive për kthim për personat e zhvendosur

**Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim/ Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenës Sociale**

1. Sa është numri i personave të zhvendosur të rikthyer, të cilët janë regjistruar në komunën tuaj?  
  
2. Sa është numri i shtëpive të (ri)ndërtuara për të rikthyerit?  
  
3. Sa është numri i aplikimeve për asistencë nga

1. Të zhvendosur të rikthyer nuk ka në këtë periudhë.  
  
2. Nuk ka shtëpi të kryera në këtë periudhë.

		fondi për ri-integrime?  4. Sa është numri i aplikimeve për zhvillimin e bizneseve nga personat e riatdhesuar?	3. Janë <b>3 familje</b> që kanë aplikuar.  4. Nuk ka aplikime në këtë periudhë .	
7.2. Puna dhe roli i Këshillat Lokale për Siguri Publike, (KLSP) dhe Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi, (EVS) të cilat përveç që duhet të jenë funksionale ato duhet të jenë edhe produktive	Zyra e Kryetarit të Komunës	1. A është themeluar KKSB në Komunën Tuaj?  2. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga KKSB ?  3. A është themeluar Këshilli Lokal për Siguri Publike (KLSP) në komunën tuaj ?  4. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga (KLSP) ?  5. A është themeluar EVS në Komunën tuaj?  6. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga EVS ?	1. Po , KKSB –ja është e themeluar në Komunën tonë.  2. Në këtë periudhë janë mbajtur 6 takime .  3. Po është themeluar Këshilli Lokal për Siguri Publike (KLSP).  4. Çdo dy muaj takohen me Polici, OSBE ,KFOR . Si dhe në takimet e KKSB-së.  5. Jo nuk është themeluar EVS.  6. Jo ende .	

		<p>7. A janë themeluar Këshillat e Fshatrave në komunën tuaj konform Udhezimi Administrativ 02/2019 MAPL për bashkpunimin e komunës me fshatra, nëse po të bashkëngjiten vendimet përkatëse?</p> <p>8. Sa takime kanë mbajtur në këtë periudhë?</p>	<p>7. Komisioni është duke punuar, është në proces .</p> <p>8.//</p>	
<b>8. ARSIMI DHE KULTURA</b>				<b>Neni 107 Arsimit dhe trajnimi - MSA</b>
8.1.Ngritja e kapaciteteve teknike për Arsimin Gjithpërfshirës	<b>Drejtoria e Arsimit</b>	1. Sa trajnime janë mbajtur gjatë periudhës raportuese për mësimdhënës ?	1.Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur trajnime të tilla.	

<p>8.2. Rritja e nivelit të pjesëmarrjes së fëmijëve në institucionet e edukimit parashkollor dhe fëmijët me nevoja të veçanta</p>	<p><b>Drejtoria Arsimit</b> e</p>	<p>1. Sa është numri i çerdheve funksionale (<i>publike dhe jo-publike</i>) në komunën tuaj?</p> <p>2. Sa është numri i fëmijëve prej moshës 0-5 vjec që janë të përfshirë në çerdhe?</p> <p>3.Sa është numri i fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët janë përfshirë në çerdhe?</p>	<p>1.Çerdhja publike “Xhevë Lladrovci” në Klinë dhe çerdhja private “Margherita Kids” në Zllakuqan.</p> <p>2. <b>139</b> ëshë numri i fëmijëve të grupmoshave të ndryshme që vijojnë në çerdhe.</p> <p>3.Janë <b>8</b> fëmijë me nevoja të veçanta në çerdhen publike, kurse për çerdhen private nuk kemi të dhëna zyrtare.</p>	
<p>8.3. Raportim me të dhëna mbi numrin e braktisjes së shkollimit nga komuniteti pakicë, në veçanti komuniteti RAE. Veprimet konkrete të ndërmarra nga komuna në parandalimin e mëtejshëm të braktisjes së shkollimit</p>	<p><b>Drejtoria Arsimit</b> e</p>	<p>1.Komuna juaj a has në mungesë të librave shkollore në gjuhët e komuniteteve pakicë?</p> <p>2.Sa është numri i rasteve të braktisjes së shkollimit nga komuniteti jo shumicë?</p> <p>3.A ka organizuar komuna juaj trajnime për ekipet e parandalimit të braktisjes së shkollës, nëse po ju lutem specifikoni numrin e trajnimeve?</p> <p>4. A ka hartuar komuna juaj Planin e veprimit për parandalimin e braktisjes</p>	<p>1. Tekstet shkollore i aprovon MASHTI.Në Komunën tonë nxënësit e komuniteteve ekzistuese mësojnë me tekste shkollore me të cilat shërbehen edhe nxënësit shumicë.</p> <p>2.Në vitin 2023 në sistemin e MASHTI-t SMIA (Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim) nuk është raportuar asnjë rast i braktisjes nga ana e nxënësve të komuniteteve.</p> <p>3. Brenda periudhës së raportimit nuk ka pasur trajnime të tilla.</p> <p>4. Jo. Hartimi i planit është në proces.</p>	

		<p>dhe të mosregjistrimit e shkollimit për komunitet jo shumicë (rom dhe ashkali) konform strategjisë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare, nëse po ju lutemi të bashkangjiteni këtë Plan?</p> <p>5. A janë formuar ekipet për parandalimin e braktisjes së nxënësve në shkolla në komunën tuaj?</p>	<p>5. Po. Edhe në nivel Komunal, edhe në nivel shkolle.</p>	
<b>9. MJEDISI</b>				<b>Neni 115 Mjedisi- MSA</b>
<p>9.1. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë</p>	<p><b>Drejtoria e Shërbimeve Publike</b></p>	<p>1. A është hartuar plani komunal për menaxhimin e mbeturinave konform ligjit nr. 04/1-060 për mbeturina. Nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar?</p> <p>2. Sa është numri i fushatave të ndërmarra për ndërgjegjësimin publik për sistemin e menaxhimit të</p>	<p>1. Po , Plani komunal për menaxhimin të mbeturinave është miratuar dhe gjendet në faqen zyrtare të Komunës.</p> <p><a href="https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2023/04/Plani-komunal-per-menaxhimin-e-mbeturinave-2023-2027.pdf">https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2023/04/Plani-komunal-per-menaxhimin-e-mbeturinave-2023-2027.pdf</a></p> <p>2. Janë ndërmarrur 3 fushata vetëdijësue për</p>	

		<p>mbeturinave?</p> <p>3.Cilat janë veprimet e ndërrmara nga komuna e Obiliqit për mbrojtjen e qytetarëve lidhur me mbylljen e liqenit të depozitës së hirit të qymyrit që operohet nga KEK-u dhe deponisë së Mirashit ? Obiliqi</p> <p>4. A është hartuar plani i veprimit për cilësinë e ajrit në komunën tuaj, konform Ligjit nr. 03/1-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar ( shihni nëse Planet lokale të veprimit për cilësinë e ajrit janë pjesë integrale e planeve lokale për mjedis) ?</p>	<p>sistemin e menaxhimit të mbeturinave.</p> <p>4. Jo s'kemi Plan për cilësinë e ajrit në Komunën tonë.</p>	
9.2 Numri i madh i deponive ilegale duhet të adresohet urgjentisht	<b>Drejtoria e Shërbimeve Publike</b>	1. Sa është numri i deponive ilegale në komunën tuaj dhe çfarë masa ka ndërmarrë komuna për të eliminuar këto deponi?	1.Gjithesejt kemi 31 deponi ilegale .	

<p>10.1 Mbrojtja e Shëndetit të Nënës, Fëmijës dhe Shëndetit Riprodhues</p>	<p>Drejtorja e Administrates /Drejtorja e shëndetësis</p>	<p>1. A ka pasur fushata vetëdijësues në komunën tuaj lidhur me shëndetin riprodhues ?</p> <p>2.Sa trajnime ka organizuar komuna juaj për shëndetin e nënës dhe e fëmijës?</p>	<p>1.Fushata vetëdijësuese është organizuar në bashkëpunim me organizatën ECMI Kosova . Trajnim është bërë në 3 faza:</p> <p>-Faza e parë ka qenë Kampi i të rinjve që ka zgjatur 3 ditë me nxënësit e Shkollës së MesmeTeknike " Fehmi Agani" në Klinë.</p> <p>-Faza e dytë ka përfshirë ligjërata me nxënësit e shkollave te mesme në Klinë , 20 ligjërata për shëndetin riprodhues;</p> <p>- Faza e tretë ka qenë ligjëratë e mbajtur me gra shtatzëna dhe femra të Komunës se Klinës.</p> <p>-Gjithashtu kemi mbajtur edhe ligjërata në kuadër te ZHVP dhe EVP.</p> <p>Është mbajtur edhe një punëtori 3 ditore me nxënës të paraleles së Shkollës së Mesme të Mjekësisë.</p> <p>2.Për shëndetin e nënës dhe fëmijës kemi takime të shpeshta sepse në kuadër të QKMF- së ekziston Programi për nëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare. Sipas këtij Programi mamitë e QKMF-së takojnë shumë shpesh gratë me fëmijët e tyre, ju mbajnë ligjërata dhe japin këshilla .</p>	
---	---	--	---	--